

# P R E S S R E L E A S E

European Union  
Delegation of the European Union

Shkup, 10 janar 2013

## **Përfundoj projekti për arritje të barazisë gjinore në komunitetet rurale**

**Të premtën, më 11 janar të vitit 2013, në ora 10:30, në Qendrën Informative të BE-së u mbajt konferencë përfundimtare e projektit të financuar nga BE-ja “Arritje të barazisë gjinore në komunitetet rurale”.**

**Në këtë eveniment, fjalime hyrëse mbajtën:**

**Sh.T. z. Aivo Orav, Shef i Delegacionit të BE-së;**

**Znj. Elena Grozdanova, Këshilltarë shtetëror për barazinë gjinore, Ministri për punë dhe politik sociale;**

**Z. Hazbi Idrizi, Kryetarë i Komunës së Bogovinjes;**

**Z. Enver Pajaziti, Kryetarë i Komunës së Bërvenicës;**

**Z. Bajram Kadria, Kryetarë i Komunës së Vrapçishtës;**

**Z. Fatmir Izairi, Kryetarë i Komunës së Zhelinës.**

**Znj. Sanela Skrijelj, koordinatore e projektit nga Asociacioni për zhvillim rural prezantoi rekomandimet e projektit për zbatim me cilësi më të madhe të Ligjit për barazi gjinore në nivel komunal.**

Barazia gjinore është një nga prioritetet e legjislacionit të BE-së dhe këto parime janë të përfshira në të gjithë programet të promovuar dhe të përkrahura nga BE-ja. Andaj, projekti i financuar nga BE-ja **“Arritje të barazisë gjinore në komunitetet rurale”** kishte për qëllim ti promovoj politikat, mekanizmat dhe vlerat të cilat duhet të ofrojnë mundësi më të mëdha si për gratë ashtu edhe për burrat, me qëllim që ti plotësojnë prioritetet individuale dhe të përfshihen në mënyrë aktive në zhvillimin e komunitetit të tyre rural.

Objektivi kryesor i projektit ishte që të mundësoj zhvillim efikas, social dhe të drejtë dhe ta rris barazinë gjinore në komunitetet rurale përmes institucionalizimit të qasjes që e promovon barazinë gjinore në proceset e krijimit të politikave në nivel lokal. Projekti ka qenë i realizuar në katër komuna të rajonit të Pollogut: Bogovinjë,

# P R E S S R E L E A S E

**European Union**  
Delegation of the European Union

Brvenicë, Vrapcishtë dhe Zhelinë, në periudhën Janar – Dhjetor 2012, me buxhet prej mbi 70.000 euro.

Aktivitetet e projektit i prodhuan këto rezultate:

- **Kapacitetet e institucioneve lokale, kapacitetet e komisioneve për mundësi të barabarta dhe OJQ nga komunat përkatëse për promovim të barazisë gjinore të zmadhuara**
- **Është përmirësuar bashkëpunimi për promovimin e barazisë gjinore ndërmjet të gjithë palëve kompetente në nivel komunal**
- **Janë krijuar dhe miratuar plane lokale akcionale për barazinë gjinore**
- **Vetëdije e ngritur e popullatës**